



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 151/14
Prishtinë, më 08.04.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Albana Fetoshi, Muhamet Musafa, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Mungoi: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj-Ministër i Financave, Arbër Morina shefi i kabinetit- në MASHT, Midin Bjaxhiu- KPMM , Haredin Gërvalla –KPMM, Ramiz Krasniqi- KPMM, Alexaundra Fehlinger dhe Rejahana Zylfijaj nga GIZ, Haxhi Gashi- USAID .

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 02.04.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për kredi ekportuese ndërmjet Republikë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria A.G. lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e- Edukimit”**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2013;**
- 5. Shqyrtimi i Rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri, lidhur me funksionimin e Agjencive dhe Rregullatorëve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja : konstatoj që rendi i ditës miratohet pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 02.04.2014

Sevdije Lama në pikën kur është shqyrtuar Raporti vjetor financiar i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2013, në diskutimin e saj, është bërë një lëshim teknik, në vend të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është shkruar Ministria e Financa. Prandaj, kërkojë që të bëhet ky përmirësim.

Kryetarja: konstatoj se miratohet procesverbali me vërejtjet e deputetes Sevdije Lama.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për kredi eksportuese ndërmjet Republikë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria A.G. lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e- Edukimit

Kryetarja: marrëveshja për kredi eksportuese e nënshkruar në mes Kosovës dhe Unicredit Bank Austria ka të bëjë me financimin e modernizimit të sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit. Kushtet e marrëveshjes duken që janë të volitshme. Për 5 vite nuk do të ketë pagesë për amortizim dhe pagesa për shlyerjen e kredisë fillon nga viti 2023 dhe kthimi bëhet në 19 këste 6 mujore, në shumë prej 259,529 euro.

Besim Beqaj: marrëveshje është nënshkruar më herët, ndërkaq në buxhetin e këtij viti është paraqitur si hua e jashtme në kuadër të buxhetit të MASHT-it. Kemi të bëjmë me një kredi të butë dhe e cila bazohet në marrëveshjen për financimit që është 20 milion euro që bëhet në transfere të ndryshme dhe i ka të përcaktuara edhe sferat ku mundën të cilat financohet nga kjo kredi. Sa i përket kushteve, shifet se norma e interesit është 0% , tarifa e garancionit është 1.1% në baza vjetore, kurse maturiteti është prej 18 vitesh.

Arbër Morina: ky projekt ka 5 komponenta, përveç komponentit kryesorë që është digjitalizimi i provimit të maturës, përfshin aftësimin e autorëve dhe punëdhënësve në krijimin e përmbajtjes mësimore elektronike, krijimin e përmbajtjes mësimore elektronike, krijimi i portalit mësimor dhe krijimi i shërbimeve rreth mësimin elektronik dhe të portalit. Ministria e Arsimit do të krijojë një server në të cilin do të bëhet administrimi kryesorë i provimit të maturës. Si benefit i portalit mësimor elektronik ka edhe qasjen në përmbajtjen e sofistikuar të mësimëve multimediale, administrim të shfrytëzuesve, administrimin e kurseve dhe të përmbajtjeve mësimore, menagjimin e burimeve dhe kohës, mësim të kombinuar, platformë të pavarur dhe mundëson qasjen e shumë shfrytëzuesve në të njëjtën kohë e në disa gjuhë. Na është mundësuar fleksibilitet nga ana e kompanisë që projekti të plotësoj ndryshime, varsisht nga nevojat dhe kërkesat që mund të dalin nga ministria e arsimit. Periudha e realizimit të këtij projekti parashihet të jetë 36 muaj.

Hykmete Bajrami: pyeti a ka filluar projekti apo kur ka me fillue, se u permend kompania që do të ofrojë fleksibilitet në realizimin e projektit?

Arbër Morina: sqaroi se nuk ka filluar projekti, por do të fillojë pasi të përfundohen procedurat në ministrinë e financave. Por Ministria e Arsimit e ka zgjedhur kompaninë përmes procedurave të prokurimit dhe kompani fituese është nga Austria dhe pritët që të kryhen anët formale, ratifikimi i marrëveshjes dhe pastaj fillon realizimi i projektit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për kredi ekportuese ndërmjet Republikë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria A.G. lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e- Edukimit.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2013

Kryetarja: theksoi se KPMM ka sjellur raportin financiar vjetor sipas formularëve standard. Shifet se ky komision, buxhetin e ka realizuar 81.6 %, kurse ajo qka është paraqitur në të hyrat vetanake shofim se ka një mosrealizim prej 3 milion eurove, në krahasim me atë qka është planifikuar.

Ramiz Krasniqi: në vitin 2013 janë realizuar 10 projekte kapitale dhe buxheti i shpenzuar në këtë kategori është 76.7%. Janë realizuar projekte shumë të rëndësishme për vlersimin ekonomik të resurseve dhe hartave gjeologjike. Ndër projektet janë ndërtimi i kater plansetave të hartave gjeologjike, menagjimi resurseve minerale. Sa i përket të hyrave, kemi pasur rritje kjo si rezultat i rritjes së rentes minerale të qymyreve. Po ashtu të hyra ka pasur edhe nga taksa administrative, gjobat që të gjitha arrin vlerën dikun 26 milion euro. Arsyeja e mosrealizimit të të hyrave është si rezultat i vonesës së lëndëve nëpër gjykata që ka paraqitur KPMM, ndaj operatorëve ilegal.

Latif Gashi: theksoi se përveç raportimit keni bërë kërkesë për shtimin e mjeteve për 30,000 euro për paga dhe mëditje, një sqarim për qfarë është fjala, kur dihet se dihet se ministria e financave për vitin 2014 iu ka rritur buxhetin për këtë kategori për 30,000 euro.

Muamet Mustafa: unë mendoj që raporti është mjaftë informativ, përfshinë shumë gjëra për punën e komisionit, shifet se janë dhënë dikun 20 licenca për punim metalesh, kisha dasht një specifikim për qfarë metalesh është fjala? Mund të krahasojmë dhe konstatojmë që janë rritur të ardhurat në buxhet nga tantiema. Fakturimi prej 32 milionëve është mjaftë i rëndësishëm, por thekson se nga ana tjetër na si komision na rritet përgjegjësia që të shofim që kjo tantiem t’iu kthehet komuniteteve ku nxjerren minierat dhe mineralet, për përmirësimin e ambientit edhe të kushteve të jetesës dhe jo të përdorët për rritje të shpenzimeve rrjedhëse të buxhetit. Unë kam dëshirë me e ditë sa është vlera e tantiemes së paguar nga KEK-u dhe Sharrceçi, ndërsa për FeronikliN është prezantuar.

Kryetarja: profesori e ngriti një qështje shumë të rëndësishme për shpërndarjen e një përqindje të sigurimit të një tantiemës nëpër komunitetetë ku janë ato miniera, kjo qështje është diskutuar edhe më herët por i kemi edhe disa pengesa ligjore për mundësinë e dedikimit të mjeteve buxhetore. Megjithatë ideja e parafolësit është e mirë dhe me interes që duhet të mendohet në të ardhmen.

Ramiz Krasniqi: sqaroi se KPMM ka nje bazë të dhënave të cilën nuk e kanë shtetet në rajon, ku të gjitha të dhënat apo licencat që jepen janë të futur në bazën e të dhënave dhe e kemi planifikuar një projekt për avancimin e saj. Shtimi i mjeteve për 30,000 eurove ka ndodhur si kërkesë e vazhdueshme se realisht kemi mungesë të inspektorëve të terrenit, të cilët kryesisht e bëjnë inspektimin e operuesve ilegal dhe licencimin e kompanive.

Haradin Gërvalla: sqaroi se në vitin 2014, KPMM ka kërkuar 73,000 euro, që janë për 8 pozita që janë në proces të rekrutimit, ndërkaq ministria e financave na ka lejuar vetëm 30,000 euro për vitin 2014.

Latif Gashi: sa është paga mesatare në institucionin e juaj?

Haradin Gërvalla: sqaroi se stafi profesional është me koeficient 8.

Kryetarja: theksoi se kur e kemi bërë buxhetin për vitin 2014, kemi kërkuar një listë të pagave që e kanë sjellë, dhe e kemi parë që ky komision ka shtesa prej 30 eurove por edhe të tjera jashtë shërbimit civil. Prandaj kemi kërkuar që të miratohet ligji për pagat e funksionarëve të lartë publik dhe të jetë i përcaktuar se si po si paguhet stafi i këtyre institucioneve të pavarura dhe me qenë staf civil dhe me i fut në sistem.

Hykmete Bajrami: po më duket që kemi hyrë në një temë që nuk është temë e diskutimit tashë kur po shqyrtojmë raportin financiar, por edhe paraqitja e kërkesës së këtyre në raport vjetor është e pavend. Kur të vie koha me u marrë me kërkesa buxhetore për vitin 2015, mundemi me e shqyrtu një gjë të tillë dhe ndoshta deri atëherë mundemi me i ba disa rregulla.

Ramiz Krasniqi: sa i përket kthimit të mjeteve nga licencat, disa komuna kanë pasë kërkesë që nga këto të hyra që inkasohen nga KPMM me iu kthy komunave me projekte, për shkak se bëhet ndotja e mjedisit në ato pjesë ku punohet dhe komunat nuk kanë gjetur mirëkuptim me ministrinë dhe qeverinë. Vlera e tantumës së KEK-ut është 18,721,185 euro. Feronikli në vitin e kaluar ka pas disa problem me prona private dhe ka paguar rentë 1,746,213 euro, Sharcemi ka paguar 282,000 euro rentë minerale.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2013.

5. Shqyrtimi i Rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri, lidhur me funksionimin e Agjencive dhe Rregullatorëve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit

Kryetarja: siç keni mundur të vëreni në rend dite, Kryesia e Kuvendi i ka ngarkuar të gjitha komisionet, që të shqyrtojnë disa rekomandime që i ka nxejrr komisioni për zhvillim ekonomik, lidhur me agjencionet e pavarura. Janë disa qështje që janë ngritur këtu dhe nuk përputhen me legjislacionin përkatës që kemi. Është kërkuar që të formohet një drejtori në kuadër të Kuvendit apo njësisia ndërlidhëse. Po ashtu nga rekomandimet shohim se është kërkuar që të hartohet një ligj i cili rregullonë punën e të gjitha agjencioneve dhe rregullatorëve, por nuk e di se në këtë ligj a hynë ligji për pagat e funksionarëve publik apo duhet me qenë një ligj i veçantë. Unë mendoj se është dashur që komisionet të punojnë bashkarisht, të formohen grupe punues në komisione dhe të nxjerren rekomandime të përbashkëta që janë në interes për rregullimin e kësaj problematike. Një qështje tjetër që nuk është përmendur në këto rekomandime është qështja reduktimit e këtyre institucioneve të pavarura që janë shumë, dhe ne ndoshta duhet të japim një rekomandim për mundësin e reduktimit e këtyre institucioneve. Lidhur me këtë qështje është angazhuar

edhe GIZ dhe kanë bërë disa komente dhe sugjerime dhe unë mendoj se duhet të merremi më seriozisht dhe të dalim me rekomandime konkrete nga këndi i komisionit tonë.

Hykmete Bjarami: është mirë që një komision ka marrë një iniciativë për rregullim e kësaj problematike, edhe unë pajtohem që nuk është përgjegjësi e vetme e këtij komisioni, sepse mbikëqyrja e këtyre agjensioneve është e shpërndarë nëpër komisione të ndryshme, por një barrë shumë e madhe na takon neve si komision për buxhet e financa. Është dashur paraprakisht të konsultohemi dhe me qenë pjesë e grupit punues dhe të japim mendimet tona. Unë mendoj se këto janë rekomandime të mira por ka vende për përmirësime. Përpilimi i një ligji të veçantë për rregullimin e të gjitha agjensioneve, unë e shoh si shumë problematike sepse secili agjension e ka ligjin mbi të cilin është themeluar. Qështja e rregullimit dhe harmonizimit të pagave duhet të jetë pjesë e ligji për pagat e zyrtarëve të lartë publik, sepse aty ne kemi mundësi që ti krahasojmë dhe të kemi baza referuese me institucionet tjera. Sa i përket raportimit deri më 31 mars dhe shqyrtimit të këtyre raporteve deri më 31 korrik, unë mendoj që raportet financiare dhe raportet e auditorit nuk duhet trajtuar ndaras. Raporti financiar duhet të shqyrtohet nga i njëjti komision që shqyrton raportet e auditorit. Komisioni për buxhet e financa duhet të përqëndrohet në pjesën e buxhetit dhe duhet të merremi më shumë me qështjet e aspektit makroekonomik dhe shpërndarjen e buxhetit. Sa i përket të themelimit të një regullatori apo njësisë brenda Kuvendi është e nevojshme dhe Kuvendi ka mjaft staf dhe duhet të bëjë lëvizje të stafit dhe të formohet një zyrë që duhet t'iu ndihmojë të gjitha komisioneve funksionale në mbikqyrjen e punës së këtyre agjencioneve. Qështja shumë thelbësore është pavarësia e tyre, sepse ne kemi pa që këto institucione quhen të tilla por që nuk janë të pavarura. Nuk kam mundur me pa logjike që këto agjensione i raportojn Kuvendit, e në fakt bordet i propozon qeveria. Po ashtu është propozuar që nëse Kuvendi nuk miraton raportin të merren sanksionet, por unë besoj që në këto rekomandime duhet parashihen edhe masat ndëshkuese. Propozimi im është nëse raporti nuk votohet nga Kuvendi, në seancën e radhës të thirret kryetari e bordit dhe nëse ai nuk mundet me justifikim raportin, atëherë, Kuvendi le të merr vendim për shkarkimin e bordit, nuk ka arsye tjera.

Kryetarja: mendoj se është e nevojshme të formojmë një grup punues prej tre vetash që të analizojë më në detale dhe të dalim me rekomandime të qarta. Komisioni për mbikqyrjen e financave publike ka për obligim të shqyrtoj raportet e auditorit gjeneral. Një praktikë e këtillë e ngjashme është edhe në vendet ku është i themeluar ky komision si i pavarur, rasti i Britanisë së Madhe dhe Sllovenisë, prej nga edhe është ndërtuar koncepti i krijimit të komisionit tek ne. Sa i përket asaj që raportet financiare të kalojnë në komisionin për mbikëqyrje, unë mendoj nëse kalojnë tek ai komision, ne si komision për buxhet dhe financa nuk ka me pas informata fare se si është shpenzuar buxheti. Qëllimi i analizës së raportit financiar është të shikohet rrjedha e shpenzimeve nga ajo që është planifikuar. Ndërkaq efektshmëria e shpenzimit të mjeteve dhe shkeljet eventuale i kostatton auditori gjeneral, dhe mandej merret komisioni për mbikëqyrje.

Hykmete Bajrami: unë mendoj se është shumë humbje kohe të merremi me shqyrtimin e raporteve financiare ndaras nga raportet e auditorit. Përndryshe duhet me pasura bashkëpunimi me komisionin tonë me atij të mbikqyrjes së financave publike, duhet me qenë një grup punues përmanent, që merrë pjesë në mbledhjet e komisionit për mbikqyrjen e financave publike, kur shqyrtohen raporte e agjensioneve të pavarura.

Kryetarja: nëse kalojnë raportet financiare për shqyrtim në komisionin tjetër, komisioni për buxhet do të jetë i mangët në shqyrtimin e kërkesave buxhetore. Ne nuk jemi marrë më seriozisht me shqyrtimin e raporteve financiare sepse iu kishim qasur pak më ndryshe.

Albana Fetoshi: unë në fakt jam që raportet financiare të agjensioneve të ndryshme të shqyrtohen në komisionin për buxhet dhe financa, por kishte me qenë mirë që së bashku me këto të kishin qenë të bashkangjitura edhe raportet e auditorit ku do të mund të shifnim saktësinë e shpenzimeve dhe do të kishim një ndërlidhje pastaj edhe me buxhetin që ne shyrtojnë. Një vërejtje tjetër ka të bëjë me raportin tre mujor të shpenzimeve të buxhetit, që nëse analizohet shifet se shpenzimet janë të paraqitura të përgjithësuar, nuk ka detaje për shpenzimet kapitale dhe nëse krahasojmë me buxhetin, nuk mundesh me gjetë asgjë të specifikuar sepse është shumë i përgjithësuar. Kishte me qenë mirë me e marrë një vendim në si komision dhe ma ja dërgue një vërejtje me shkrim qeverisë, që kur të dorëzohen raportet financiare të vjenë ashtu siç duhet dhe kërkohet.

Kryetarja: unë nuk jam pajtuar asnjëherë që komisioni për mbikëqyrje të financave publike me qenë i veçantë, ndoshta në rrethanat e Kosovës, më mirë kishte me qenë në kuadër të komisionit për buxhet dhe financa si nënkomision, i cili do të merrej me raportet e auditimit dhe do të raportonte në komision. Sa i përket raporteve financiare, zakonisht ministria e financave i përgadit raportet duke përfshirë kërkesat që janë paraparë në ligjin për menagjimin e financave publike. Ne si komision për buxhet mundemi të kërkojmë shtesë për ndonjë qështje që neve na intereson, nëse ministria e financave nuk i përshtatet ligjit qka parasheh me e paraqit në raportin financiar. Po ashtu ne mundemi me i shqyrtue raportet tremujore financiare nëse ka interes nga deputetët, por ligji thotë se vijnë vetëm për njoftim.

Latif Gashi: realisht shumica e temave që u diskutuan këtu janë të përfshir në këto rekomandime komisionit funksional. Rekomandimi i 6 parasheh që në raportin vjetor përveq tjerash duhet të përfshihen edhe niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të Zyrës së Auditorit Gjeneral. Është mirë që ne po formojm një grup punues dhe është mirë që ky grup punues të kryej detyrën sa më shpejtë dhe ato rekomandime që nxjerren të na dërgohen të gjithëve që të mund të japim kontributin tonë.

Xhevdet Neziraj: theksoi se raporteve financiare na ndihmojnë për të parë rrjedhen e shpenzimeve të buxhetit. Unë jam i mendimit që duhet një bashkëpunim më i mirë në mes komisionit për buxhet dhe financa dhe komisionit për mbikëqyrjen e financave publike. Raportet ndonjëhere nuk po kalojnë dhe përgjegjësi po kemi edhe ne, pasi që nuk po i zgjedhim anëtarët e bordit në Kuvend. Unë mendojë se duhet të bërë analiza për funksionimin e numrit të agjencioneve, për të parë se ndoshta mundemi me bë bashkimin e shumë agjensioneve me veprimtari të përafërt dhe kjo do të ndikonte që të jenë më efikase në kryerjen e detyrave të tyre.

Kryetarja: ta kuptojmë esencën e raportit financiar, paraqitet mënyra e shpenzimeve të mjetëve por ne nuk e kemi për obligimë ta shyrtojm efektivitetin e shfrytëzimit të mjeteve të këtyre e analizon komisioni për mbikëqyrjen e financave publike. Ne e kemi bërë një kërkesë që qdo raport i auditimit me na ardhë edhe në komisionin për buxhet, por kurr nuk i kemi pranuar kur nuk na ka ardhur. Nëse i heqim edhe raportet financiare nuk e di qfarë po mbetet në veprimtarinë e këtij komisioni. Ne po mbetemi pastaj të merremi vetëm me planifikimin e buxhetit dhe me të hyrat buxhetore dhe zhvillimin makroekonomik.

Muhamet Mustafa thekson se janë bërë disa konkluzë që janë mirëseardhura. Shpeshë herë kemi biseduar për këtë qështje dhe parimisht nuk jam kundër që të nxirret një ligj i veçantë, por këtu po

nxirret ligj mbi ligjet sepse një rregullator është formuar me një ligj të caktuar, ku është përcaktuar mënyra e funksionimit, e zgjedhjes së bordit, etj. Te qështje e prioritetit të auditimit jamë sa më shpejt të bëjë auditori, por sipas mendimit tim, prioritet duhet dhënë organizatave që shpenzojnë më shumë buxhet, që janë kryesisht ministrinë e caktuara. Sa i përket rekomandimit 8, krijimi Zyrë ndërlidhëse apo Drejtorisë së posaqme pse me u formue. Unë mendoj se një lloj servisi për disa funksione administrative për këto agjensi kishte mundur me u ofruar, por nuk mundemi me pas gjithkund një auditor të brendshëm një njeri që mirret me prokurim, për burime njerzore etj. Qështja e pavarisë të këtyre agjensioneve është esenciale, por pavarësia tyre nuk ka me u mbërri asnjëhere në qoftë se qeveria i nominon anëtarët e bordeve pasi që është normale që partitë që janë në pushtet kanë me i zgjedh gjithmonë partizanët e vet politik dhe unë mendoj se ne duhet këtë qështje me ia lënë Kuvendit, përkatësisht komisioneve apo paneleve përkatëse.

Latif Gashi: sa i përket auditimit ne e kemi i rekomandimet 2 dhe 5 të komisionit funksional ku thuhet se agjensionet e pavarura i dorëzojnë raportet në Kuvend më së largu deri 31 mars, dhe në rekomandimin 6 është propozuar që në raportet vjetore të agjencive të pavarura të përfshihen edhe rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të vitit paraprak për çdo agjension, dhe kjo është një risi që përpara nuk ka qenë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kreytarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Cakohet Grupi Punues për shqyrtimin e Rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturrë, Tregti dhe Industri, lidhur me funksionimin e Agjencive dhe Rregullatorëve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit, dhe hartimin e raportit me rekomandime për mbledhjen e radhës së komisionit.

Mbledhja përfundoi: 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj